

VENDIM
Nr. 893, datë 12.12.2012

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR
DISA INSTITUCIONE NË VARËSI TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË, SI AUTORITETE
KONTRAKTORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e disa institucioneve në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, të përfundojnë brenda datës 25 dhjetor 2012, procedurat e prokurimit për furnizimin me mallra, me fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për vitin 2012, sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Brenda këtij afati përfshihen dhe lidhja e kontratave përkatëse e njoftimi i këtyre kontratave të nënshkruara në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha